

UDHËZIM
Nr. 529, datë 19.7.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 27.5.2021,
“PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL, SI DHE
ASPEKTET E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJES SË
NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT
PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË
PERSONELIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4 të nenit 12, dhe të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 15, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 14, datë 27.5.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 15 të kreut IV, shtohet pika 2 me përmbajtjen si më poshtë:

“2. Drejtoria Qendrore e AKPA-së auditon në mënyrë periodike ofruesit e AFP-së, në përputhje me legjislacionin për auditin e brendshëm”.

2. Në nenin 16 të kreut V, ndryshohet si më poshtë:

Në pikën 1 togfjalëshi “pavarësisht zonës gjeografike”, shfuqizohet.

Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

4. “Kur në një ofrues të AFP-së, në vitin akademik paraardhës ka pasur kërkesa më të mëdha se numri i nxënësve të regjistruar për drejtim mësimor, për aplikimet e bëra brenda 7 ditëve nga hapja e regjistrimeve, nxënësit përzgjidhen sipas vlerësimit të kriterëve në radhë: vendbanimit të nxënësit brenda qarkut ku operon ofruesi, mesatares më të lartë të notave të dëftesës së arsimit bazë, datës më të hershme të aplikimit. Në rast se ka kapacitete të lira pas vlerësimit të bërë për aplikimet e bëra në 7 ditëshin e parë, pranimi bëhet sipas parimit kush aplikon i pari pranohet i pari bazuar në mesataren minimale të pranuar një vit më parë për drejtimin mësimor. Në raste të veçanta, drejtoria e ofruesit të AFP-së, përcakton kuota bazuar në kriterë të posaçme, në bazë të prioritetëve dhe objektivave të planit afatmesëm”.

3. Në kreun V, në nenin 17, ndryshohet si më poshtë:

Fjalja e parë e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

1. “Ofruesit e AFP-së publikojnë në mjediset e jashtme dhe në faqen e internetit të AKPA-së, një javë para fillimit të regjistrimeve informacion mbi procesin e regjistrimit me këto të dhëna:”

Pika 2 shfuqizohet.

Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

3. “Aplikimi për regjistrim bëhet online dhe aplikanti duhet të ngarkojë në sistem dokumentet si më poshtë:

a) Kopje e dëftesës së arsimit bazë;

b) Kërkesë për drejtimin mësimor që do të ndjekë”.

4. Në Kreun VI, neni 21, bëhen këto ndryshime:

Pika 1, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

1. “Ofruesit e AFP-së publikojnë në mjediset e jashtme dhe në faqen e internetit të AKPA-së, një javë para fillimit të regjistrimeve informacion mbi procesin e regjistrimit me këto të dhëna:”.

Pika 2 shfuqizohet.

Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

3. *“Aplikimi për regjistrim bëhet online dhe aplikanti duhet të ngarkojë në sistem dokumentet si më poshtë:*
 - a) *Kopje e diplomës së shkollimit të mëparshëm;*
 - b) *Kërkesë për profilin mësimor pas të mesëm që do të ndjekë”.*
5. Në kreun VII në nenin 24, pika 1, ndryshohet si më poshtë:
 1. *“Aplikimi për regjistrimin në formimin profesional, të punëkërkuësve të papunë të regjistruar pranë strukturës vendore të punësimit, bëhet nëpërmjet referimit nga kjo e fundit përmes sistemit elektronik”.*
6. Në kreun VII, në nenin 24 pika 3 ndryshohet si më poshtë:
 3. *“Regjistrimi për kurset bëhet online në sistemin elektronik”.*
7. Në kreun XVII, neni 69, pika 2, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:
 - b) *“Të ketë 3 (tre) vjet përvojë pune nga të cilat 1 (vit) përvojë pune në menaxhim”.*
8. Në kreun XVII, neni 70, pika 6, ndryshohet si më poshtë:

Togfjalëshi *“vijon me procedurën e shpalljes së vendit të lirë”* zëvendësohet me togfjalëshin *“vijon me procedurën e ngritjes në detyrë”.*
9. Në kreun XVII, pas nenit 70 shtohet neni 70/1, me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 70/1

“Ngritja në detyrë”

1. *“Në rastin kur vendi vakant i drejtorit të ofruesit të AFP-së, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, Drejtoria Qendrore e AKPA-së, shpall procedurën e ngritjes në detyrë për të gjithë punonjësit brenda sistemit të AFP-së, të një kategorie paraardhëse.*
2. *Njoftimi për ngritjen në detyrë bëhet në faqen zyrtare të AKPA-së,, në faqen elektronike zyrtare të ofruesit, nëse ka, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ofruesit të AFP-së, që ka vendin e lirë brenda 5 (pesë) ditëve pune.*
3. *Shpallja për ngritjen në detyrë përmban kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për marrjen në punë të drejtorit të ofruesit të AFP-së, dokumentet që duhet të paraqiten dhe afatin e aplikimit.*
4. *Kërkesa për ngritje në detyrë dhe dokumentacioni përkatës dorëzohen në protokollin e Drejtorisë Qendrore të AKPA-së,, brenda 5 ditëve nga shpallja.*
5. *Në rast se vendi vakant nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë brenda sistemit të AFP-së, vijohet me procedurën e shpalljes së vendit të lirë për të gjithë kandidatët e tjerë nga jashtë sistemit të AFP-së, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi”;*
10. Në kreun XVII, neni 71, pika 1, ndryshohet si më poshtë:
 1. *„Togfjalëshi “pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele” ndryshon me togfjalëshin “pas përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë”.*
11. Në kreun XXII, neni 118, titulli i nenit ndryshon si më poshtë:

Detyrat e sekretarit të shkollës:

Paragrafi i parë i nenit ndryshohet si më poshtë:

Sekretari i shkollës kryen detyrat e mëposhtme:
12. Në kreun XXIII, të nenit 122, pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me përmbajtjen si më poshtë:

5/1. *“Kritere të posaçme për specialistin e burimeve njerëzore/juristit:*

 - a) *të ketë të paktën nivelin arsimor bachelor, në shkenca shoqërore/juridike në shpalljen për pozicionin përkatës;*
 - b) *të ketë përvojë në punë të paktën 3 vjet sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës;*
 - c) *të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit”.*
13. Kudo në udhëzim togfjalëshi *“mësimdhënës i praktikës profesionale”* bëhet *“mësimdhënës/instruktor i praktikës profesionale”.*

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Blendi Gonxhja